

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQERISE TREGTARE "3A Solar Power"

Në Elbasan, sot më dt 07.10.2022 (shtatë tetor dymijë e njezet e dy) ortakët themelues :

**Z. Fejzi Ago**, shtetas Shqiptar, atësia Shaqir, i datëlindjes 26.04.1962, lindur dhe banues në Elbasan, madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike, njohur me Nr. letërnjoftimi 037276633 dhe numër personal G20426002F, lëshuar më 20.05.2021,

**Z. Xhino Ago**, shtetas Shqiptar, atësia Mehedi, i datëlindjes 21.08.1993, lindur dhe banues në Elbasan, madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike, njohur me Nr. letërnjoftimi 033200195 dhe numër personal J30821079J, lëshuar më 29.08.2016,

kanë vendosur themelimin e shoqërisë tregtare "**3A Solar Power**" sh.p.k.

Në baze të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" dhe të ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregëtare në Republikën e Shqipërisë, me vullnetin e tyre të lirë, themeluar si më poshtë vijon , të ndryshuar sipas nenit 68 të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" dhe të ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

### NENI 1

#### THEMELIMI I SHOQERISE

Ortakët themelues të shoqërisë janë shtetasit shqiptarë Fejzi Ago dhe Xhino Ago.

Shoqëria, e formuar me iniciativen e ortakëve themelues, konsiderohet e themeluar në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkangjitur këtij akti. Shoqëria i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do t'i nënshtrohen legjislacionit të vendit ku do të ketë qendrën dega.

Degët e shoqërisë do të ushtrojnë veprimtarinë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie dhe brenda kompetencave që do t'u jenë dhënë me aktet e krijimit apo me akte të tjera të veçanta.

### NENI 2

#### E DREJTA

**Shoqëria "3A Solar Power" sh.p.k.**, është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve themelues, që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi së ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit".

### NENI 3

#### PERGJEGJESIA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.



Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj ndaj të tretëve.

Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut ne veçanti, po për humbjet e shoqërisë deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

#### **NENI 4**

#### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqëria e ka selinë e saj në Elbasan, Rr Elbasan - Metalurgji km2, ZK 2124, Nr P 51/22

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

#### **NENI 5**

#### **KOHEZGJATJA**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar duke filluar fill pas rregjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Kombëtar të Bizneseve.

#### **NENI 6**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Veprimtari ekonomike-juridike në fushën e energjitikës, prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike. Krijimi i sistemeve elektroenergjitike, projektimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve përprodhimin e energjisë. Prodhim, import-eksport të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, duke përmendur vecanërisht sistemet me panele fotovoltaike. Shit-blerjen e energjisë elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtar, sipas legjislacionit dhe lejeve të organeve kompetente. Ndërtim, projektim dhe zbatim të të gjitha linjave elektrike, interkonjeksionit për transmetimin e energjisë elektrike. Prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjisë elektrike, për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm dhe me kosto të ulët për klientët tariforë paralelisht me vënien në punë të burimeve të reja dhe përmiresimin e atyre ekzistuese. Si dhe të kryejë/krijojë/veprojë për të realizuar të gjitha veprimet juridike, sipas përkufizimeve ligjore, të përcaktuara në ligjet për energjinë elektrike dhe atë të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Shoqëria ka si qëllim fitimin, për të arritur këtë qëllim, ka të drejtë të kryejë aktivitete mobiliare, imobiliare dhe financiare në favor të vet dhe të të tretëve, nëse është në interes të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i nënshruar i shoqërisë do të jetë i përberë nga kontributi në para i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) lekë. Ky kapital ndahet sipas kuotave më poshtë:

- **Z. Fejzi Ago**, shtetas Shqiptar, atësia Shaqir, i datëlindjes 26.04.1962, me Nr. letërnjoftimi 037276633 dhe numër personal G20426002F, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 70 % te vlerës së kapitalit themeltar (70.000 Lekë)

- **Z. Xhino Ago**, shtetas Shqiptar, atësia Mehedi, i datëlindjes 21.08.1993, me Nr. letërnjoftimi 033200195 dhe numër personal J30821079J, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 30 % te vlerës së kapitalit themeltar (30.000 Lekë)

Kapitali themeltar është nënshkruar në total nga ortakët. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga ortakët.

#### **NENI 8**

#### **VULA E SHOQERISE**


Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje: **"3A Solar Power" SH.P.K**

#### **NENI 9**

#### **ORGANET DREJTUESE**

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

- Mbledhja e Ortakëve – Asambleja e Ortakëve - Organi më i lartë vendimmarrës.
- Administratori - organi administrativ dhe ekzekutiv i kompanisë

9.2 Shoqëria do të drejtohet nga administratori, me një afat qëndrimi në detyrë 5 vjet më të drejtë rizgjedhjeje. Administrator i **"3A Solar Power"** është Anisa Ago, atësia Fejzi, me nr personal I85704016H dhe nr letërnjoftimi 031289843, me specimen nënshkrimi 

9.3 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në cdo kohe nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të zakonshme.

E drejta për të përfaqësuar shoqërinë para cdo organi shtetëror, privat, bankar , gjyqësor , etj ushtrohet nga Administratori i Shoqërisë ose nga një person tjetër i autorizuar me prokurë nga Administratori.

#### **NENI 10**

#### **BAZA LIGJORE PER NDRYSHIMET**

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, administratorët, kapitalin, selinë, ortakët, objektin e veprimtarisë, etj, sipas vendimit që do të merret nga Mbledhja e Ortakëve- dhe sipas kërkesave të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare" duke depozituar vendimin pranë Rregjistrimit Tregëtar të Qendres Kombëtare të Rregjistrimit.

#### **NENI 11**

#### **EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

Eksperti kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme. Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko - tregtare të shoqërisë.



**NENI 12**  
**KONFIDENCIALITETI**

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, cdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj

**NENI 13**  
**MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nepërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës ne fuqi. Shoqëria merr përsiper të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që te respektojnë statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të pergjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**NENI 14**  
**ZBATIMI I LIGJIT**

Për sa nuk është shprehur në këtë Akt Themelimi dhe Statut, vlejnjë dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqërite Tregëtare” ; Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” dhe ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregëtare në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 15**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**NENI 16**  
**VLEFISHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij akti – themelimi e të statutit bashkëlidhur aktit. Ky akt përpilohet në 4 kopje të barazvlefshme ligjërisht, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë. U nënshkrua me vullnet te lirë nga ortakët.

**O R T A K E T**

**Z. Fejzi Ago**

Fejzi Ago  


**Z. Xhino Ago**

XHINO AGO  
